



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 10068 Prot

Vlorë, më 22.05. 2026

Lënda: Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë, datë 28.05.2026.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE
Znj. Brunilda Mersini

PREFEKTIT TË QARKUT VLORE
Znj. Evis Allushi

Ju njoftoj se, **ditën e enjte, datë 28.05.2026, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4 ku pas;

1. Shprehje për ligjshmërinë e VKB Nr 48 – 56, datë 30.04.2026.
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, për muajin prill, datë 20.04.2026 dhe datë 30.04.2026,

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin Prill 2026”
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2026”.
3. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e banesës të znj. Rudina Lazemetaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
4. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës të znj. Doreza Buqe dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
5. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës të znj. Natasha Papa dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

6. Projektvendim "Për një ndryshim në VKB Nr 61, datë 19.08.2022 "Për një shtesë në Vendimin Nr 80, datë 02.12.2021 "Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për ato në territorin e Bashkisë Vlorë".
7. Projektvendim "Për miratimin e bonusit të qirasë që përfitojnë familjet, banesat e të cilave preken nga zbatimi i projektit "Rikonstruksion i Kanalit të Ujrave të Larta " Vlorë".
8. Projektvendim " Për miratimin e subvencionit të qirasë që përfitojnë familjet në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre qiranë e tregut të lirë".
9. Projektvendim "Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara".
10. Projektvendim "Për miratimin e subvencionit të qirasë që përfitojnë familjet dhe individët e prekur nga zbatimi i projektit "Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier – Vlorë" sipas VKM Nr 254, datë 09.05.2018".
11. Raport i monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën Janar – Prill 2026.
12. Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 23.12.2026 "Për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026", indryshuar".
13. Projektvendim "Për një saktësim në VKB Nr 109, datë 23.12.2025 "Për dhënien e dakortësisë për krijimin e servitutit të kalimit publik në pasurinë e përcaktuar në planin e rievimit, ZK Nr 3467 në favor të pasurisë Nr 2/2/2, ZK Nr 3467".
14. Projektvendim "Për zëvendësimin e disa përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë në bordet e institucioneve arsimore parauniversitare".
15. Të ndryshme.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë ditën e premte datë 22.05.2026, ora 12:00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e hënë, datë 25.05.2026, ora 10:00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e hënë, datë 25.05.2026, ora 11:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e hënë, datë 25.05.2026, ora 12:00.

Komisioni për arsimin, kulturën dhe sportet do të mbledhet ditën e hënë, datë 25.05.2026, ora 13:30.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR
Elpiniq Merkuri

